

VENDIM
Nr.1535/1, datë 26.11.2008

**PËR TJETËRSIMIN E PRONËSISË SHTETËRORE TË TRUALLIT NGA PRONË
SHTETËRORE NË PRONË PRIVATE, PËR “COLACEM ALBANIA”, SHPK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 757-760, të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë“, të ndryshuar, të neneve 3, shkronja “b”, e 8, paragrafi i parë, të ligjit nr.7890, datë 27.7.1995 “Për shitblerjen e trojeve”, dhe të neneve 4, 5, 10, 11, 12 e 13 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Tjetërsimin e pronësisë shtetërore, me sipërfaqe 5760 (pesë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë) m² dhe 36 415 (tridhjetë e gjashtë mijë e katërqind e pesëmbëdhjetë) m², në administrim, përkatësisht, të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe bordit të kullimit, Lezhë, sipas genplanit/planvendosjes, që i bashkëlidhet këtij vendimi, nga pronë shtetërore në pronë private, për “Colacem Albania”, sh.p.k.

2. Pagimi i çmimit nga “Colacem Albania”, shpk-ja, do të bëhet në natyrë, me sipërfaqen e lirë të truallit, prej 43 175 (dyzet e tre mijë e njëqind e shtatëdhjetë e pesë) m², që ka në pronësi kjo shoqëri.

3. Pronësia e truallit t’i kalojë nga organi, që e ka në administrim, “Colacem Albania” sh.p.k., përmes një kontrate tjetërsimi mbi pasuritë e paluajtshme, nënshkruar nga të dyja palët, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Autorizohet Drejtori i Përgjithshëm i Rrugëve për të nënshkruar kontratën e shkëmbimit, në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha